



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisioni i Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Barazisë Gjinore

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar të bashkisë berat 2026–2028”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet bazuar në nenin 8 pika 2, nenin 9 pika 1/1.1 gërma “b”, nenin 23 pika 12, nenin 24 pika 1, nenin 54 gërma “k”, neni 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Ky plan përbën një **instrument strategjik** i ndërtuar mbi një analizë të detajuar të realitetit lokal dhe të sfidave që has sistemi arsimor parauniversitar në territorin e bashkisë sonë. Plani u përgatit nga Grupi i Punës për Hartimin e Planit të Arsimit Parauniversitar, i ngritur nga Kryetari i Bashkisë me Urdhër Nr 309, dt 07.05.2025 , si dhe **me mbështetjen e Shoqates për Autonomi Vendore.**

Plani synon të garantojë aksesin, cilësinë dhe gjithëpërfshirjen në të gjitha institucionet arsimore (38 kopshte, 36 shkolla të arsimit baze dhe të mesëm, 2 konvikte dhe 1 QKF +1 Qender Rinore).

Sfidat kryesore të identifikuar janë:

- Përmirësimi i mëtejshëm i kushteve të higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes në institucionet arsimore, duke ndjekur një plan të detajuar emergjencash.
- Forcimi i kapaciteteve njerëzore mbështetëse, si mësues ndihmës, psikologë , punonjës socialë dhe punonjës mbështetës, për arsimin parashkollor sidomos në zonat rurale.
- Modernizimi i mëtejshëm i infrastrukturës ekzistuese dhe pajisjes me mjete didaktike bashkëkohore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Mbështetja e vazhdueshme për grupet vulnerabël, përfshirë fëmijët romë, egjiptianë, me nevoja të veçanta dhe në rrezik social.
- Krijta e mëtëjshme e aksesit dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në aktivitete kulturore dhe edukative jashtëmësimore.

INVESTIMET E PARASHIKUARA 2026-2028 DHE BURIMET FINANCIARE

Plani parashikon një sërë investimesh të dedikuara për periudhën 2026–2028, përfshirë:

- Rikonstruksionin e 13 kopshteve dhe shkollave.
- Modernizimin e sistemit të ngrohjes dhe sigurisë.
- Pajisje didaktike dhe materiale mësimore
- Lidhje me internet dhe mjete digjitale edhe për arsimin parashkollor
- Përmirësim të kushteve sanitare dhe të aksesit fizik në zonat rurale.

Burimet financiare do të mbështeten në:

- Buxhetin vendor të Bashkisë Berat.
- Transfertat e pakushtëzuara dhe specifike nga qeveria qendrore.
- Mbështetjen e partnerëve të zhvillimit dhe organizatave donatore.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Arsimit e Bashkisë Berat

Impakti social / grupet që preken:

Vizioni është të ndërtojmë një mjedis edukues gjithëpërfshirës, të sigurt dhe frymëzues për çdo fëmijë dhe të ri në territorin e Bashkisë Berat – ku arsimi, përkujdesja, mirërritja dhe zhvillimi kulturor bashkohen në shërbim të potencialit të tyre të plotë, përmes institucioneve me standarde të larta, staf të përkushtuar dhe infrastrukturë cilësore e të qëndrueshme.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Plani përmban:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Mekanizma të qartë të monitorimit.
- Indikatorë matës të progresit dhe ndikimit.
- Raportim vjetor dhe rishikim afatmesëm.
- Përfshirje të aktorëve lokalë dhe komunitetit në procesin e vlerësimit.

Komisioni i Përhershëm për **i Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Barazisë Gjinore**, i mbledhur në datën 11/09/2025, shqyrtoi projekt vendimin **“Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar të bashkisë berat 2026–2028”** relacionin e dokumentat shoqërues propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Arsimit

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

1. Të miratojë Planin e Arsimit Parauniversitar 2026 – 2028 të Bashkisë BERAT,

Komisioni i Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Barazisë Gjinore

Florenca Demollari- Kryetar i Komisionit

Donald Molishti-Anëtar

Kejsi Hoxha-Anëtar

Anduena Hazizolli-Anëtar

Barije Kanaci-Anëtar

Datë 11 /09/2025